

V E N D I M
Nr.330, datë 26.6.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.36, DATË
31.1.1994 “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PËR DHËNIEN E LEJEVE PROFESIONALE
NË SEKTORIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE”**

Me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.36, datë 31.1.1994, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1.”Personat fizikë ose juridikë, të interesuar në fushën e studimit, projektimit, zbatimit të punimeve dhe zhvillimit të veprimtarive të ndryshme në sektorin e pyjeve dhe kullotave, të pajisen me leje profesionale në përputhje me rregulloren dhe udhëzimin përkatës”.

2.Ky ndryshim të pasqyrohet edhe në udhëzimin dhe rregulloren e komisionit për dhënien e lejeve profesionale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi